REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Fuqizohemi së bashku...

Janar – Qershor 2026

AMSHC ➢ Ditar 34

Datë: ***08.07.2026***

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

Mbahet Mbledhja e parë për vitin 2026 e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile..... 2

Takime informuese me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile për vendet vakante si anëtarë të Shoqërisë Civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile 3

Takime informuese dhe konsultime publike me Organizata të Shoqërisë Civile në kuadër të Thirrjes Nr. 19.....6

Njoftim! Hapja e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile në KKSHC..... 7

Thirrje nr. 19 për projekt-propozime (10 Mars 2026 deri 14 Prill 2026) 8

Takim informues me përfaqësues të shoqërisë civile për instrumentin e Facilitetit për Reforma dhe Rritje (RGF).....10

Konsultim publik në kuadër të procesit të bashkë-krijimit për Planin e ri të Veprimit OGP 2026-2030.....11

Takimi i Ekipit Tematik të Strategjisë së Mbrojtjes së Viktimave të Krimit.....13

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 4 22 355 69
Website: www.amshc.gov.al *E-mail:* info@amshc.gov.al

Mbahet Mbledhja e parë për vitin 2026 e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 15 Janar 2026

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në funksionin e Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, zhvilloi në datën 15 Janar 2026 në orën 10:00 në mjediset e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, mbledhjen e rradhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.





Nën drejtimin e Z. Vladimir Thano, Nënkryetar i Këshillit, dhe në prezencë të anëtarëve të qeverisë, të shoqërisë civile, dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, u mbajt mbledhja e parë kombëtare e KKSHC-së për vitin 2026.





Gjatë mbledhjes disa nga çështjet që u diskutuan ishin:

- Përditësimi mbi zgjedhjet e KKSHC-së dhe prezantimi me anëtarët e rinj të KKSHC-së
- Ngritjen e një grupi pune mbi hartimin e kalendarit të aktiviteteve dhe prioriteve për KKSHC-në (roli dhe funksionet);
- Diskutime mbi procesin e zgjedhjeve për anëtaret e rinj të KKSHC-së (mbarimi i madateve për 8 anëtarë në shkurt 2026).



Takime informuese me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile për vendet vakante si anëtarë të Shoqërisë Civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile

Janar - Shkurt 2026

Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile organizoi takime me të gjitha OJF-të e interesuara për të marrë pjesë në takimet që u mbajtën në kuadër të informimit për proçesin e zgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile.

Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile ka zhvilluar disa takime informuese me përfaqësues të Shoqërisë Civile në kuadër të thirrjes për pjesëmarrje mbi proçesin e përzgjedhjes së 8 (tetë) vakancave të krijuara për anëtarët e Shoqërisë Civile në KKSHC.
Për të gjithë palët e interesuara aplikimet u hapën duke filluar nga data 26 Janar deri me 2 Mars 2026.

Aktivitetet vijuan me prezencën e të ftuarve dhe prezantimin e qëllimit të takimeve ku të pranishmit, morën pjesë aktivisht në takime.



Takimet u mbajtën me përfaqësues të ndryshëm të Shoqërisë Civile dhe u prezantuan në mënyrë të hollësishme mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Përvç këtyre dhe mbi sfidat që kishte hasur ndër vite funksionimi i KKShC-së. U prezantuan disa nga temat aktuale që Këshilli po përballej dhe gjithashtu për arritjet që ky Këshill kishte realizuar.



Temat kryesore si më poshtë:

- Problematika mbi regjistrin elektronik të OJF-ve dhe lidhja me sistemin e ri që po përgatitet nga Drejtoria e Tatim Taksave;
- Zbatueshmëria e Ligjit që përjashton OShC-të nga detyrimi i TVSH-së ;
- Mbi proçesin e hartimit të Udhërrëfyesit të Ri për Shoqërinë Civile;
- Procesi integrimit të Shqipërisë në BE, roli i organizatave të shoqërisë civile në këtë proces dhe në përfshirjen e Komitetit të Përbashkët Konsultativ të shoqërisë civile;
- Bashkëfinancimi publik për projektet e BE-së dhe formulari i përjashtimit nga TVSH për projektet e financuara nga BE;
- Përfundimi i suksesshëm i Raportit të Vlerësimit brenda afateve të parashikuara;

Më pas takimet vijuan duke njoftuar të pranishmit për përfundimin e mandateve të disa anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile dhe u paraqitën si mëposhtë fushat e veprimit dhe numri i anëtarëve që ju ka mbaruar afati për të qënë anëtarë të KKShC-së.

- **Fusha e Veprimit A** – *Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE*, **ka hapsirë për 2 (dy) anëtarë.**
- **Fusha e Veprimit B** – *Zhvillimi ekonomik, territorial e mjedisor*, **ka hapsirë për 2 (dy) anëtarë.**
- **Fusha e Veprimit C**- *Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës,* **ka hapsirë për 4 (katër) anëtarë.**





Në vijim u shpjeguan dokumentat të cilat duhet të dorëzojë çdo aplikant i cili ka interes për të qënë anëtar në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile. Dokumentat janë të përcaktuara në rregulloren e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.



Pas kësaj u shpjegua në mënyrë të detajuar se si do ishin fazat e kandidimit, dhe se si do të funksinonte votimi për kandidatët që kalonin në këtë fazë.

Takime informuese dhe konsultime publike me Organizata të Shoqërisë Civile në kuadër të Thirrjes Nr.19

Shkurt – Mars 2026

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile , dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut si dhe në kuadër të Ligjit Nr. 146/ 2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik";

Procesi i konsultimit publik në kuadër të përcaktimit të prioriteteve mbi thirrjes e radhës në qytete e Shqipërisë si mëposhtë:



- Sarandë në datën 10 Shkurt 2026 Hotel Nertili
- Gjirokastër në datën 11 Shkurt 2026 Hotel Cajupi
- Përmet në datën 12 Shkurt 2026 Vila Përmeti
- Korçë në datën 16 Shkurt 2026 Hotel Vila Eden
- Vlorë në datën 19 Shkurt 2026 Hotel Internacional Vlora
- Diber në datën 24 Shkurt 2026 Hotel Veri
- Shkodër dhe Malësi e Madhe në datën 26 Shkurt 2026
- Tiranë në datën 2 Mars pranë ambjeteve të AMSHC



Gjithashtu ftoi të gjitha OJF-të e interesuara dhe të pamundura për të qënë pjesë e takimit të dërgojnë në adresën e emailit info@amshc.gov.al të gjitha sugjerimit e tyre në kuadër të prioriteteve mbi shpalljen e thirrjes nr. 19.

Takimet u zhvilluan në një atmosferë konstruktive dhe u karakterizua nga pjesëmarrje aktive e përfaqësuesve të shoqërisë civile lokale. Diskutimet u fokusuan në:

a) Identifikimin e sfidave me të cilat përballen organizatat në terren;
b) Nevojën për mbështetje të qëndrueshme institucionale;
c) Rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sektorit civil dhe institucioneve publike;
d) Sugjerime konkrete për përmirësimin e politikave mbështetëse.



Pjesëmarrësit vlerësuan organizimin e takimeve dhe shprehën interes për vazhdimësi të këtyre komunikimesh. Të gjitha gjetjet, sugjerimet apo prioritetet janë përmbledhur dhe do përfshihen në shpalljen e thirrjes nr. 19.

NJOFTIM PËR HAPJEN E PROCESIT TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË SHOQËRISË CIVILE NË KKSHC

2 Mars – 6 Prill 2026

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, nis proçesin e përzgjedhjes së 8 (tetë) vakancave të krijuara për anëtarët e Shoqërisë Civile në KKSHC.



Vakancë e krijuar për shkak të përfundimit të mandateve :

2 (dy) anëtarë – Fusha e veprimit A. Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE;
2 (dy) anëtarë – Fusha e veprimit B. Zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor;
4 (katër) anëtarë – Fusha e veprimit C. Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës;



KRITERET PËR KANDIDATËT DHE DOKUMENTACIONET MBËSHTETËSE:

Dokumentet që duhen dorëzuar nga organizatat që nominojnë kandidatët:

1. Formulari i Aplikimit, i publikuar nga AMSHC
2. Kopje e dokumentit të regjistrimit në Gjykatë
3. Konfirmim nga zyra e e tatimeve që organizata e ka statusin "aktiv"

Kriteret që duhen përmbushur nga kandidatët për KKSHC:

1. Të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë në rol drejtues në organizata të shoqërisë civile në fushën ku kandidon.
2. Të mos ketë role koordinuese ose drejtuese në organizata politike ose parti politike;

Dokumentet që duhen dorëzuar nga të nominuarit:


1. Jetëshkrimi (CV – Curriculum Vitae);
2. Letër motivimi nga kandidati për të shpjeguar kontributin që mund të japë pranë KKSHC-së
3. Letër konfirmuese nga organizata e shoqërisë civile se kandidati ka të paktën 3 (tre) vite eksperiencë në fushën ku kandidon;
4. Pesë letra mbështetëse nga organizata të tjera të cilat mbështesin kandidatin.

Shënim: Një organizatë e shoqërisë civile mund të propozojë vetëm një kandidat nga të dy fushat e veprimit të referuara më sipër. Formulari i plotësuar së bashku me të gjithë dokumentacionin mbështetës, të listuar në Thirrjen Publike për Shprehje interesi duhet të dërgohen elektronikisht me e-mail në kkshc@amshc.gov.al me referencë të saktë të subjektit: "**Propozim Kandidature për KKSHC"** ose me postë në adresën AMSHC*: Rr. Frosina Plaku, Nr. 58 Tiranë, Shqipëri.*

THIRRJE NR. 19 PËR PROJEKT-PROPOZIME (10 Mars 2026 deri 14 Prill 2026)

10 Mars -14 Prill 2026

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenet 8, 21, 22, 23, të Ligjit Nr. 10 093, datë 09.03.2009 *"Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile",* në nenet 5, 10, të VKM-së 769/2009 *"Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile",* e ndryshuar, Vendimit 02 të Bordit Mbikqyrës të datës 03.03.2026 dhe akteve nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi, në përputhje me fushën e saj të veprimtarisë, **SHPALL** këtë Thirrje për shprehje interesi për aplikime nga ana e OJF-ve që operojnë në Republikën e Shqipërisë.



Gjatë takimeve të zhvilluara nga përfaqësuesit e AMSHC-së dhe OJF-ve të ndryshme apo pushtetit vendor, janë prezantuar nga ana e institucionit tonë qëllimet e zhvillimit të takimeve dhe janë dëgjuar propozimet e tyre për prioritetet sipas fushës së veprimtarisë dhe në përfundim duke konsultuar në tërësi janë grupuar propozimet për prioritetet.
Nga diskutimet e shumta të bëra nga pjesëmarrësit në takime, përfaqësuesit e OJF-ve dhe grupet e tjera të interesit si dhe nga shqyrtimi i të gjithë materialit të marrë në rrugë elektronike dhe në formë të shkruar (hard copy), ku pjesëmarrësit listuan të gjitha sugjerimet e tyre, u arrit në përfundim se Shoqëria Civile ndeshet me problematika dhe sfida të shumta, të cilat kërkojnë zgjidhje. Duke marrë parasysh rolin e AMSHC-së në përputhje me ligjin në fuqi pasi u finalizuan takimet e programuara në kuadër të konsultimit publik.

Për të gjitha OJF-të e interesuara që përmbushin kriteret ligjore, jeni të lutur të depozitoni aplikimet tuaja për projekt-propozime sipas fushave prioritare (bashkangjitur) dhe duke depozituar dokumentacionin si më poshtë:

Fushat mbi përparësitë/prioritetet të projekt-propozimeve:

1. Vullnetarizmi dhe Angazzhimi qytetar;
2. Pjesëmarrja dhe fuqizimi i të rinjve;
3. Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe mbështetja për grupet vulnerabël;
4. Fuqizimi ekonomik dhe social i grave;
5. Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm;
6. Promovimi i kulturës dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore;
7. Forcimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile;
8. Lufta kundër korrupsionit dhe edukimi ligjor i publikut;
9. Lufta kundër dezinformimit dhe lajmeve të rreme

Sjellim në vëmendjen tuaj se:
Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore që dalin për zbatim të tij për strategji të ndryshme qeveritare, do të konsiderohen me prioritet të gjitha ato projekt-propozime, të cilat kanë në fokus tregues që janë shtylla në Strategjitë e miratuara nga qeveria.

Konsultim publik në kuadër të procesit të bashkë-krijimit për Planin e ri të Veprimit OGP 2026-2030

27 Mars - 02 Prill 2026

Në kuadër të procesit të bashkë-krijimit për Planin e ri të Veprimit OGP 2026-2030, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) organizoi takime konsultuese si mëposhtë:

- Dibër në datë 27.03.2026
- Berat në datë 31.03.2026
- Tiranë në datë 02.04.2026

Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP) është një nismë vullnetare ndërkombëtare që synon të sigurojë angazhime të qeverive në promovim të transparencës, fuqizimit të qytetarëve, luftës ndaj korrupsionit, dhe shfrytëzimit të teknologjive të reja për forcimin e qeverisjes. Shqipëria është bërë anëtare e OGP-së në shtator të vitit 2011.
Përsa më sipër, lutemi për pjesëmarrjen tuaj në takime, për cdo pyetje dhe informacion ju lutem na shkruani në adresën info@amshc.gov.al

Takim informues me përfaqësues të shoqërisë civile për instrumentin e Facilitetit për Reforma dhe Rritje (RGF)

Tiranë, 09 Prill 2026

Në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar për Facilitetin e Reformave dhe Rritjes, Drejtoresha e Përgjithshme e #SASPAC, Eridana Çano, zhvilloi një takim informues me organizata të shoqërisë civile në vend, ku morën pjesë edhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Diskutimet u fokusuan në progresin e deritanishëm, sfidat dhe hapat e ardhshëm në zbatimin e Agjendës Kombëtare të Reformave.

Përfshirja aktive e shoqërisë civile në këtë proces vlerësohet si një kontribut shumë i rëndësishëm.

Takimi u përshëndet nga drejtuesit ekzekutiv të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI), të cilët kanë memorandume bashkëpunimi me #SASPAC si dhe në rolin e monitoruesve të pavarur të Agjendës Kombëtare të Reformave.

Konsultim publik në kuadër të procesit të bashkë-krijimit për Planin e ri të Veprimit OGP 2026-2030

10 Mars -14 Prill 2026

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile morën pjesë në Konferencën e parë Rajonale në lidhje me programin ReLOaD 3, i cili zhvillohet në vazhdimësi të programeve ReLOaD 1 dhe ReLOaD 2, i zbatuar nga programi i Kombeve të bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe i financuar nga Bashkimi Europian.



Programi është i përqendruar në forcimin e demokracisë dhe bashkëpunimin midis autoriteteve vendore dhe organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-të).

Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3) është një nismë rajonale e financuar nga Bashkimi Europian dhe e zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Programi synon të forcojë angazhimin qytetar dhe partneritetet midis qeverive vendore (QVs) dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) për të krijuar komunitete më të hapura, gjithëpërfshirëse dhe rezistente.

ReLOaD3 ndërton mbi suksesin e fazave të mëparshme (ReLOaD1 dhe ReLOaD2), të zbatuara nga viti 2017 deri në 2024 në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

ReLOaD3 (shkurt 2025 – janar 2029) synon të:

- Forcojë vetëqeverisjen vendore dhe angazhimin e shoqërisë civile në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor.
- Rrisë kapacitetet e qeverive vendore dhe OSHC-ve për të krijuar partneritete efektive, përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe për t'i përafruar ato me prioritetet e zhvillimit lokal.
- Përmirësojë dialogun dhe bashkëpunimin midis QV-ve dhe OSHC-ve përmes promovimit të praktikave të transparencës në financimin e OSHC-ve.
- Mbështesë qëndrueshmërinë e OSHC-ve përmes zhvillimit të kapaciteteve.
- Inkurajojë qeveritë vendore të adoptojnë dhe ruajnë standarde të larta transparence dhe llogaridhënieje.
- Nxisë dialog të orientuar drejt rezultateve midis OSHC-ve, banorëve dhe autoriteteve, duke kontribuar në qeverisje vendore më gjithëpërfshirëse dhe zhvillim të qëndrueshëm komunal.



Mjedisi Politik:
Krijimi i një mjedisi të favorshëm politik dhe një rrjeti aktorësh për të mundësuar zgjerimin e mekanizmave transparentë të financimit për OSHC-të.



Ndërtimi i Kapaciteteve: Rritja e kapaciteteve të qeverive vendore dhe OSHC-ve për dialog efektiv dhe zbatim të skemave të granteve lokale.

Angazhimi Qytetar: Mbështetja e autoriteteve vendore, shoqërisë civile dhe banorëve për të nxitur angazhim më të madh qytetar në hartimin, ofrimin dhe monitorimin e politikave lokale.

Partneritetet: Forcimi i partneriteteve midis autoriteteve dhe shoqërisë civile dhe rritja e mbikëqyrjes civile mbi politikat publike në Kosovë përmes rrjetëzimit rajonal dhe futjes së mjeteve digjitale.

Buxheti i përgjithshëm për ReLOaD3 është 13.4 milionë USD



Takimi i Ekipit Tematik të Strategjisë së Mbrojtjes së Viktimave të Krimit dhe prezantohet Strategjia e re për të Mitur 2027–2030

Tiranë, 3 Qershor 2026

Më 3 qershor 2026 u zhvillua takimi i Ekipit Tematik të Strategjisë së Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, i cili shërbeu njëkohësisht si aktivitet lançues i Strategjisë së re për të Mitur 2027–2030. Ky takim përbëri një mundësi të rëndësishme për prezantimin e objektivave dhe prioriteteve të reja strategjike, si dhe për diskutimin e masave që synojnë forcimin e sistemit të drejtësisë për të mitur dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Gjatë takimit u prezantuan drejtimet kryesore të strategjisë së re, duke vënë theksin te nevoja për një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse ndaj të miturve, veçanërisht atyre në konflikt me ligjin. Në këtë kuadër, diskutimet u përqendruan në rëndësinë e zhvillimit të mekanizmave efektivë për parandalimin e delikuencës, ofrimin e mbështetjes dhe rehabilitimit psiko-social, si dhe krijimin e mundësive për riintegrimin arsimor dhe shoqëror të të miturve.



Përfaqësues të institucioneve të ndryshme kontribuan në diskutime duke ndarë perspektivat dhe ndërhyrjet e planifikuara në fushat përkatëse të përgjegjësisë së tyre. U theksua se trajtimi i çështjeve që lidhen me drejtësinë për të mitur kërkon jo vetëm politika të qarta dhe mekanizma të qëndrueshëm mbështetës, por edhe angazhim të vazhdueshëm të të gjithë aktorëve institucionalë dhe shoqërorë.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse, si elemente thelbësore për zbatimin efektiv të prioriteteve strategjike. Bashkërendimi i përpjekjeve dhe ndërhyrjeve të institucioneve të ndryshme vlerësohet si një faktor kyç për garantimin e një sistemi më të drejtë, gjithëpërfshirës dhe mbrojtës për të miturit, si dhe për përmirësimin e shërbimeve dhe mekanizmave në mbështetje të viktimave të krimit.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), duke riafirmuar rëndësinë e përfshirjes dhe bashkëpunimit të aktorëve të ndryshëm në adresimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, parandalimin dhe fuqizimin e mekanizmave të mbështetjes.

Takimi shënoi një hap të rëndësishëm drejt prezantimit dhe promovimit të prioriteteve të Strategjisë për të Mitur 2027–2030, duke krijuar një hapësirë për dialog, koordinim dhe angazhim të përbashkët në funksion të përmirësimit të sistemit të drejtësisë për të mitur dhe garantimit të një mbrojtjeje më të mirë të të drejtave të tyre.

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 4 22 355 69
E-mail: info@amshc.gov.al *Website:* www.amshc.gov.al